



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Rr. Xhorxh Bush, Nr. 31, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 244 183 / 244 186 | E-mail: rektorati@uni-pr.edu
Ueb: www.uni-pr.edu

Nr. Prot: 32

Datë: 9 / 1 / 2026

Bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Ligjit nr. 03/L-212 për Punën, si dhe pas aprovimit të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 17.12.2025, **Universiteti i Prishtinës shpall:**

KONKURS

për pranimin e 30 (tridhjetë) praktikantëve në Administratën e Universitetit të Prishtinës

Qëllimi i Konkursit:

Universiteti i Prishtinës, duke u mbështetur në dispozitat ligjore që rregullojnë angazhimin dhe pranimin e praktikantëve për kryerjen e punës praktike në zyrat administrative të UP-së, ka për qëllim t'u ofrojë studentëve të nivelit master dhe të diplomuarve mundësi që njohuritë dhe aftësitë teorike të fituara gjatë studimeve t'i plotësojnë me përvojë praktike. Kjo praktikë synon zhvillimin profesional në fusha të ndryshme administrative dhe ofrimin e kontributit konkret në ngritjen e cilësisë së shërbimeve të Universitetit të Prishtinës.

Kriteret e përgjithshme

Kandidatët duhet të plotësojnë së paku njërin nga kriteret në vijim:

- Të jetë student/studente në studimet e nivelit master në njërin nga njësitë akademike të Universitetit të Prishtinës; ose
 - Të jetë i/e diplomuar në studimet e nivelit bachelor në njërin nga njësitë akademike të Universitetit të Prishtinës.
-

Kushtet dhe specifikat e angazhimit në punë praktike

- Të angazhuarit do të kenë kontratë për punë praktike me kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh;
- Orari i praktikës do të jetë fleksibil dhe do të koordinohet ndërmjet praktikantit dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, duke respektuar orarin zyrtar të administratës;
- Lartësia e kompensimit financiar do të jetë **200 (dyqind)** euro neto në muaj, e cila realizohet sipas procedurave të pagesave të institucionit;
- Fusha dhe zyra e realizimit të praktikës do të përcaktohen pas përzgjedhjes, varësisht nga profili profesional i praktikantit dhe nevojat organizative të Universitetit të Prishtinës;
- Praktikantët janë të obliguar t'u përmbahen Kodit të Etikës, rregulloreve të punës dhe udhëzimeve administrative të UP-së.

Dokumentet e nevojshme për aplikim

- Vërtetim për vijimin e studimeve nga fakulteti përkatës – për studentët e nivelit master (i ngarkuar në e-mailin e aplikimit);
- Dëshmi për diplomim (diploma ose certifikata e diplomimit) – për kandidatët e diplomuar (e ngarkuar në e-mailin e aplikimit);
- CV personale (e rekomandueshme).

Mënyra dhe afati i aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të aplikojnë në mënyrë elektronike përmes adresës së e-mailit:

praktikaup@uni-pr.edu

Aplikimi është i hapur nga data **09 deri më 16 janar 2026**, në ora 16:00.

Informata shtesë

Përfaqësimi i barabartë gjinor dhe mosdiskriminimi do të respektohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Inkurajohen në veçanti studentët dhe të diplomuarit me nevoja të veçanta që të aplikojnë.

